



REPUBLIKA E KOSOVËS



KUVENDI I KOMUNËS NË MALISHEVË

Komiteti për Politikë dhe Financa

Nr. 02/117

Datë: 10.03.2022

Procesverbal

i mbledhjes se -I- të rregullt për vitin 2022 e Komitetit për Politikë dhe Financa

REND I DITES

1. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.
2. Shqyrtimi i Raportit të Kompanisë Ekoregjioni-Njësia në Malishevë, për vitin 2021.
3. Shqyrtimi i Raportit të DKAË-së, për përfundimin e gjysmë-vjetorit të parë të vitit shkollor 2021/22
4. Njoftim me Planin e Punës të Zyrës së Auditorit të Brendshëm për vitin 2022
5. Themelimi i komiteteve jo obligative:
 - Komiteti për Arsim dhe Kulturë
 - Komiteti për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale dhe Persona me Aftësi të Kufizuara
 - Komiteti për Familje të Dëshmorëve, Invalid, veteranë të Luftës së UÇK-së, si dhe të Martirëve të Luftës
 - Komiteti për Diasporë
 - Komiteti për Planifikim Urban, Kadastër, Turizëm, Mbrojtje të Mjedisit dhe monitorim të projekteve publike
 - Komiteti për Bujqësi dhe Zhvillim Rural
6. Shqyrtimi i Raportit të Kompanisë Hidroregjioni Jugor - Njësia në Malishevë për vitin 2021.
7. Shqyrtimi i kërkesave.
8. Të ndryshme.

Mbledhja filloj në ora 10, të pranishëm ishin 7 anëtarë të KPF-së, Zyra për Informim, Drejtori i Financave.

Argjend Thaçi: Ju përshëndes të gjithëve, rendin e ditës e keni me material të mbledhjes. A keni dikush diçka rreth rendit të ditës? Për ishin 7 anëtarë unanimitisht.

I kemi edhe disa kërkesa që kanë ardhur nga kryetari i Komunës që i ka sjellë tani për KPF.

E kemi procesverbalin e mbledhjes se kaluar që na ka ardhur sot.

Kërkesa e kryetarit të Komunës nr.01/237 datë: 18.02.2022, për formimin e komisionit përzgjedhës, për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendës-drejtorit në institucionet arsimore në Komunën e Malishevës.

Kërkesa e kryetarit të Komunës nr.01/226 datë: 16.02.2022, për formimin e komisionit vlerësues për dhënien në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Kërkesa e kryetarit të Komunës nr.01/225 datë: 16.02.2022 për formimin e Komisionit të ankesave gjatë procedurave të dhënies në shfrytëzim afatshkurtër dhe afatgjatë të pronës së paluajtshme të Komunës.

Projekt Rregullorja për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale për vitin 2022.

Argjend Thaçi: Kush jeni që këto kërkesa dhe procesverbali të futen në rend dite? Unanimitisht ishin për.

1. Shqyrtimi dhe miratimi i procesverbalit të mbledhjes së kaluar?

Argjend Thaçi: Kush jeni për miratimin e procesverbalit? Unanimitisht ishin të gjithë.

2. Kërkesa e kryetarit të Komunës nr.01/237 datë: 18.02.2022, për formimin e komisionit përzgjedhës, për zgjedhjen e drejtorit dhe zëvendës-drejtorit në institucionet arsimore në Komunën e Malishevës.

Nebih Bibaj: Sa i përket dy emrave të propozuar nga Drejtoria për Arsim edhe kuvendi duhet ta ketë një anëtarë të propozuar, megjithatë kërkoj sqarim me sa dije në Kuvendi duhet ta ketë një anëtarë të vet.

Veton Zogaj: Në legjislaturën e kaluar ka qenë e njëjta kërkesë por kuvendi nuk e ka pas miratuar.

Blerim Thaçi: Nëse me lejohet një sqarim mbasi kam qenë drejtor i Arsimit në mandatin e kaluar. Udhëzimi Administrativ dhe Ligji është pak i pshjtjelluar i kanë pas centralizuar disa çështje dhe ne që dy vite kemi mbet pa komision se ka qenë vendim politik, sepse kuvendi nuk e pat formuar Komisionin.

Argjend Thaçi: Kush jeni qe kjo kërkesë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

3. Shqyrtimi dhe miratimi i Planit të Punës së Kuvendit të Komunës për vitin 2022.

Nebih Bibaj: Jemi me rekomanduar për Kuvend Draft Planin e Punës së Kuvendit.

Argjend Thaçi: Kush jeni qe të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

4. Shqyrtimi i Raportit të Kompanisë Ekoregjioni-Njësia në Malishevë, për vitin 2021.

Nebih Bibaj: Duhet qe me kohë t'i kemi raportet, pastaj mirë është në ndërkohë me gjetë ndonjë parcelë të mundshme për mbeturinat inerte dhe jo inerte sepse jemi keq. Në qytet kompania për mbledhjen e mbeturinave ta kryen punën si duhet sepse nuk janë duke i mbledhur mbeturinat.

Rukije Bytyqi: Ekoregjioni nuk po i kryen punët si duhet.

Veton Zogaj: Kjo kompani ka kontratë me Komunën, përgjegjëse është komuna.

Argjend Thaçi: Kush jeni qe kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

5. Shqyrtimi i Raportit të DKA E-së, për përfundimin e gjysmë-vjetorit të parë të vitit shkollor 2021/22

Nebih Bibaj: Mirë kish qenë me kanë edhe drejtoresha e Arsimit prezent në mbledhje, te pjesa e lendeve djegëse ka qenë keq me furnizim edhe sa i përket kualitetit të druve si në Shkozë, Astrazup ka qenë për keqardhje ka qenë keqpërdorim i tyre, pastaj orët janë mbajtur në këto shkolla me nga gjys ore. Kaldaja në Astrazup nuk po i plotësojke nevojat e shkollës. Po ashtu edhe angazhimi i nxënësve përdit po bjen, thuhet se janë gjetur edhe arme të një nxënës. Ata drejtor të shkollave duhet të kenë shumë kujdes sepse kanë marrë përgjegjësi, po ashtu edhe sa i përket higjienës nëpër shkolla thuhet se ska pas furnizim me mjete higjienike.

Blerim Thaçi: Unë kur kam qenë drejtor në Arsim kam pas kërkuar buxhet shtesë për mirëmbajtje të shkollave se ka pas dhe ka ende nevojë, po nuk kam gjete mbështetje. Sa i përket lendeve djegëse në shkolla ka qenë një operator i pa përgjegjshëm sepse siç e dini në kemi ende problem edhe me Oshp, neglizhence kemi edhe nga punëtorët teknik.

Veton Zogaj: Sa i përket cilësisë në shkolla shqetësuese janë edhe mungesat dhe lëvizjet e nxënësve, mirë është me ditë sa nxënës kanë migruar dhe sa e kanë ndërprerë mësimin. Siguria nëpër shkolla është shqetësuese pasi qe shumë lokale që operojnë afër shkollave s'kanë kritere dhe se dijmë se çka ju serohet aty, disa drejtor i ke prej orës 10 deri në ora 11 në kafe e jo në shkollë. Një nxënës që është zënë me arme kërkoj me dite a është dashtë me përjashtua apo me transferuar në shkollë tjetër, pastaj mirë është kanë me ba një balans mes shkollave pasi që Gjimnazi në Malishevë është mbipopulluar me nxënës e shkolla në Kijevë dhe Qendra e kompetencës me pak. Në fshatin Bubavec janë paraparë dy fusha sportive pse?. Te renovimi i shkollave një ditë e pash në fshatin Lladroc në zyrën e drejtorit plafoni kish rënë në tokë, në disa shkolla kam hasë në ora 11 shkolla e mbyllur.

Gentianë Hoti: Sa i përket ati nxënësit që ju ka gjete arma për të është vendosë masa e transferim në një shkollë tjetër ai nxënës nuk ka pas as mungesa as probleme tjera. Në shkolla pra duhet me pas sigurim, .

Blerim Thaçi: Kur nxënësit shkojnë jashtë vendit aty ska braktisje por lëvizshmëri.

Argjend Thaçi: Kush jeni qe kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

6. Themelimi i komiteteve jo obligative:

Gentianë Hoti: Komiteti në pikën 5 është i pa nevojshëm, propozoj të hiqet.

Argjend Thaçi: Ne si pikë e debatojmë në Kuvend aty vendoset.

Veton Zogaj: Ne si VV jemi pak kritik se edhe kur janë formuar nuk ka pasë ndonjë arsye për gjitha këto komitete.

Argjend Thaçi: Kush jeni qe kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

7. Shqyrtimi i Raportit të Kompanisë Hidroregjioni Jugor - Njësia në Malishevë për vitin 2021.

Argjend Thaçi: Kush jeni qe kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

8. Projekt Rregullorja për Taksa, Tarifa dhe Gjoha Komunale për vitin 2022.

Argjend Thaçi: Kush jeni qe kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

9. Shqyrtimi i kërkesave.

Argjend Thaçi: I kemi disa kërkesa që janë shtëpi ose shtalla që u janë djegur qytetarëve nga zjarri.

Kërkesa nr.06/217 e datës: 07.10.2021 e parashtruar nga z. Bujar Bedri Berisha nga fshati Carravranë, Komuna e Malishevës, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Kërkesa nr.06/25 e datës: 26.01.2022 e parashtruar nga z.Nazmi Zeqir Mazreku nga Malisheva, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Kërkesa nr.06/32 e datës: 28.01.2022 e parashtruar nga z. Zenel Mehmet Mazreku nga fshati Guriq, Komuna e Malishevës, për ndërrimin e destinimit të tokës bujqësore në tokë ndërtimore.

Argjend Thaçi: Këto tri kërkesa janë të plotësuara me dokumentacion a jeni t'i përcjellim për Kuvend?

Unanimisht ishin të gjithë për.

Kërkesa nr.02/46 datë: 07.02.2022, për këmbimin e pronës private me pronë publike.

Komiteti për Politikë dhe Financa në mbledhjen e mbajtur më datë: 18.02.2022 ka shqyrtuar kërkesën nr.02/46 datë: 07.02.2022 të parashtruar nga z.Mursel Hoti nga fshati Carrallukë, për këmbimin e pronës private me pronë publike.

Argjend Thaçi: Ne nuk jemi kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën në fjalë, a jeni që t'i japim palës një përgjigje? Unanimisht ishin të gjithë për.

Kërkesa nr.02/15 datë: 19.01.2022 të parashtruar nga Sindikata Komunale e Arsimit Parauniversitar (SKAP) në Malishevë.

Argjend Thaçi: Me qene se s'kemi kompetencë me vendose për këtë kërkesë a jeni ta përcjellim për zyrën e kryetarit të Komunës për trajtim të kësaj kërkesë.

Kërkesa nr.02/53 datë: 11.02.2022 të Këshillit të Bashkësisë Islamen në Malishevë.

Argjend Thaçi: Kush jeni qe kjo pikë të rekomandohet për Kuvend? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/55 datë: 11.02.2022, e Hajdar Gashit nga fshati Balincë për marrjen në shfrytëzim të pronës publike.

Veton Zogaj: Për me dhanë një pronë në shfrytëzim janë disa filtra nuk mundemi aq lehtë.

Argjend Thaçi: Ne nuk jemi kompetent për të vendosur lidhur me kërkesën në fjalë, a jeni që t'i japim palës një përgjigje? Unanimisht ishin të gjithë për.

Argjend Thaçi: I kemi disa kërkesa që janë shtëpi ose shtalla që u janë djegur qytetarëve nga zjarri, disave ju ishte djegur ushqimi i bagëtive të përcillen në Kuvend? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/54 datë: 11.02.2022 e parashtruar nga z. Rexhep Gegaj nga fshati Lladroc, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor të vajzës së tij Melisa Gegaj.

Kërkesa nr.02/40 datë: 02.02.2022 e parashtruar nga z. Valon Paçarizi nga fshati Drgobil, Komuna e Malishevës për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

Kërkesa nr.02/549 datë: 01.11.2021 e parashtruar nga zj. Xhilda Thaçi nga fshati Mirushë, Komuna e Malishevës, për mbështetje financiare për trajtim shëndetësor.

Argjend Thaçi: Qysh jam njoftuar këta kanë nevojë shumë të përkrahën, kush jeni që tu ndajmë nga 500 euro të treve këtyre? Unanimisht ishin për qe Valon Paçarizi, Xhilda Thaçi, Rexhep Gegaj të ndihmohen me nga 500 euro.

Kërkesa nr.02/559 datë: 03.12.2021 e parashtruar nga Zelfije Krasniqi nga fshati Drenoc

Kërkesa nr.02/561 datë: 07.12.2021 e parashtruar nga Zymrije Shijaku nga fshati Temeqinë

Kërkesa nr. 02/14 datë: 18.01.2022 e parashtruar nga Zahrije Thaqi nga fshati Carrallukë

Kërkesa nr.02/27 datë: 26.01.2022 e parashtruar nga Qendrim Bytyqi nga fshati Kërvaseri

Kërkesa nr.02/16 datë: 21.01.2022 e parashtruar nga Edison Morina nga fshati Bubavec

Kërkesa nr.02/44 datë: 04.02.2022 e parashtruar nga Rifat Kryeziu nga fshati Mleqan

Kërkesa nr.02/49 datë: 07.02.2022 e parashtruar nga Lulzim Krasniqi nga fshati Carrallukë

Kërkesa nr.02/57 datë: 14.02.2022 e parashtruar nga Shukrije Kelmendi nga Fshati Balincë

Argjend Thaçi: Në mungesë të mundësive buxhetore të Komunës së Malishevës për vitin 2022, kush jeni që këto kërkesa të refuzohen? Unanimisht ishin për.

Kërkesa nr.02/570 datë: 29.12.2021 e parashtruar nga znj. Atifete Gashi nga fshati Mleqan KK.Malishevë, për ndryshimin e banesës te banesat e socialit.

Argjend Thaçi: Kush jeni që këtë kërkesë ta përcjellim për drejtorinë për Shërbime Publike?

Unanimisht ishin për.

Ju falënderoj për pjesëmarrje.

Mbledhja përfundoi në ora 11:45

Procesmbajtësi

Naim Avdiqaj jur. i dip



Kryesuesi i Kuvendit

Argjend Thaçi